

V E N D I M
Nr. 653, datë 21.11.2001

**PËR KRITERET E PËRZGJEDHJES SË INVESTITORËVE STRATEGJIKË, TË
INTERESUAR PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME
"ALBTELECOM"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të nenit 5 të ligjit nr.8810, datë 17.5.2001 "Për përcaktimin e formës dhe të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Albtelecom" sh.a.", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Forma e tenderit për përzgjedhjen e investorëve strategjikë, të interesuar për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime "Albtelecom", të jetë tenderi i hapur ndërkombëtar me një fazë.

2. Ndërmjet investorëve, që do të kenë dërguar shprehjen e interesit, duke përmbyshur kërkesat e treguara në njoftimin publik, të publikuar në përputhje me vendimin nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investorëve strategjikë dhe për transferimin e aksioneve të zotëruara nga shteti në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë", ftesa për tender t'u dërgohet vetëm kandidatëve, që përmbyshin kërkesat e parashikuara në kapitullin III të këtij vendimi, sipas afateve të parashikuara në të.

3. Investorët strategjikë të interesuar, që do të ftohen të paraqesin ofertat e tyre më të hollësishme, të detyrueshme, duhet të përmbyshin, paraprakisht, kërkesat e mëposhtme:

-Të jenë shoqëri aksionere apo persona juridikë të ngjashëm, sipas ligjit përkatës, të krijuara sipas legjislacionit të vendit dhe të regjistruara pranë autoriteteve përkatëse ku ndodhet selia. Do të pranohen edhe bashkime, të përbëra nga shoqëri aksionere apo persona juridikë, sipas ligjit përkatës, si edhe kombinimet e investorëve, që veprojnë së bashku si konsorcium për qëllimet e kësaj blerjeje apo që synojnë të kryejnë transaksionin, nëpërmjet një shoqërie që do të krijohet ("Shoqëria e re").

-Të mos jenë aksionerë apo ortakë, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të operatorëve telefonikë kombëtarë, që veprojnë në Shqipëri.

-Të kenë një kapital tërësisht të paguar, mbi 150 000 000 (njëqind e pesëdhjetë milionë) USD apo barazvlerën e shumës në valutë, në të cilën është shprehur kapitali; vlera neto dhe, sipas rastit, vlera neto e konsoliduar, duhet të jetë të paktën 300 000 000 (treqind milionë) USD.

-Të jenë shoqëri të specializuara në fushën e telekomunikacioneve, të cilat kanë siguruar shërbime telekomunikacioni për jo më pak se 2 (dy) vjet; në rast të konsorciumeve apo bashkimit të investorëve, anëtar i kryesor të përmbyshë kërkesat e përmendura.

- Nuk do të pranohen në procedurën e tenderit palët, të cilat janë në likuidim apo nuk kanë aftësi paguese, që janë nën administrim apo në procedime të tjera, të ngjashme, apo në ndonjë procedim, që nënkupton paaftësi paguese apo ndërprerje të biznesit.

- Në rastin e kombinimit të investorëve strategjikë me investorë financiarë, investitori strategjik duhet të ketë kontrollin e aksioneve.

4. Të gjitha këto kërkesa të vërtetohen nëpërmjet certifikatave zyrtare, të lëshuara nga autoritetet përkatëse, ose me anë të dokumenteve të tjera, të shkruara, zyrtare.

5. Pas analizës së shprehjeve të interesit dhe pas verifikimit për përmbyshjen e kërkesave të mësipërme prej investorëve të interesuar, shoqëria këshilluese do t'i paraqesë, për miratim, Komitetit të Konsulencës dhe Transparencës listën e investorëve, të cilëve do t'u dërgohet ftesa për tender.

6. Në përputhje me kapitullin II të vendimit nr.329, datë 12.7.1999 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e tenderit për zgjedhjen e investorëve strategjikë dhe transferimin e aksionerëve, të zotëruara nga shteti, në shoqëritë tregtare të sektorëve me rëndësi të veçantë" dhe të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nxjerr urdhrin përkatës.

7. Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, me urdhër të motivuar dhe të bazuar në legjislacionin në fuqi, ruan, në çdo çast, të drejtën:

a) të tërhiqet nga procesi i shitjes apo ta ndërpresë atë;

b) të përjashtojë ndonjë palë të interesuar nga procesi i shitjes, ku kjo e fundit nuk gëzon të drejtën për t'u kompensuar apo dëmshpërblyer nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta